



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

**RAPORT PËRFUNDIMTAR “MBI AUDITIMIN TEMATIK TË PËRPUTHSHMËRISË”,
USHTRUAR NË KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**

RAPORT PËRFUNDIMTAR

**Mbi auditimin tematik të përputhshmërisë, të
ushtruar në bazë të autorizimit për verifikimin e
përlllogaritjes së pagave, me fokus të veçantë
ndër të tjera vjetërsinë në punë, si dhe kuadrin
ligjor e rregullator mbi të cilin mbështetet
përlllogaritja e tyre në**

Këshillin e Lartë Gjyqësor

Tiranë, janar 2021

SHKURTIME

DDPK	Drejtore e Drejtorisë së Përgjithshme në Kryeministri
INOTSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit
ISSAI	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit
KLGG	Këshilli i Lartë Gjyqësor
KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave

PËRMBAJTJA

SHKURTIME	2
I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	4
1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit	4
2. Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve	4
3. Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit	6
II. HYRJE	7
1. Objekti dhe qëllimi i auditimit	7
2. Identifikimi i çështjes	7
3. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	7
4. Përgjegjësitë e Audituesve	7
5. Kriteret e vlerësimit	7
6. Standardet e auditimit	8
7. Metodat e auditimit	8
8. Dokumentimi i auditimit	9
III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT	10
1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim	10
2. Përshkrimi i i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit	10
IV. KONKLuzion I PËRGJITHSHËM DHE OPINIONI I AUDITIMIT	19
V. GJETJET DHE REKOMANDIMET	20
VI. ANEKSET	24
VII. LISTA E DOKUMENTEVE TË AUDITIMIT	33

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit

Në zbatim të Autorizimit nr. 1029 prot., datë 19.10.2020 “Për kryerjen e auditimit tematik”, nga audituesit e KLSH-së z. J. P., përgjegjës grupi dhe z. J. L., u krye auditimi në Këshillin e Lartë Gjyqësor në datat 19.10.2020 deri më 02.11.2020, ku në përfundim të auditimit u mbajt Aktverifikimi përkatës, në prani të përfaqësuesve të subjektit të auditimit, z. R. B. me detyrë Sekretar i Përgjithshëm i Këshillit të Lartë Gjyqësor, znj. L. L., me detyrë Drejtore e Departamentit të Programimit dhe Administrimit të Buxhetit dhe z. Xh. H., me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Programimit dhe Monitorimit të Buxhetit.

Në përputhje me objektin e auditimit, u auditua me zgjedhje mbi bazë materialiteti dhe risku mënyra aktuale e sistemit të pagave dhe shpërblimeve në Këshillin e Lartë Gjyqësor, nëse veprimtaria financiare për pagat dhe shpërblimet është në përputhje me kërkesat ligjore, me rregullat e institucionit dhe parimet për një qeverisje të mirë, në përmbushje të objektivave të Këshillit të Lartë Gjyqësor, etj.

Përbërja e Këshillit të Lartë Gjyqësor:

Këshilli i Lartë Gjyqësor, është organizuar dhe funksionon sipas nenit 3 “Përbërja e Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe mandati i anëtarëve”, pika 1 e ligjit nr. 115/2016 “Për Organizimin e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, miratuar në datën 03.11.2016.

Statusi i anëtarëve të KLGJ-së:

Statusi i anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, është përcaktuar në nenin 4 “Statusi i anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, të ligjit nr. 115/2016.

Struktura e pagave dhe pensione, baza ligjore e llogaritjes së tyre:

Pagat e anëtarëve të KLGJ-së, janë sipas kriterëve të parashikuara në nenin 12 “Caktimi i pagës së magjistratit” të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Paga referuese bazë:

Paga referuese bazë, është përcaktuar në VKM-në nr. 187, datë 8.03.2017 “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në Kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e Presidentit, Kuvendit, Komisionit Qendror të zgjedhjeve, gjykatën e lartë, prokurorinë e përgjithshme, disa institucione të pa varura, institucionet në vartësi të kryeministrit, institucione në vartësi të ministrive të linjës dhe administratën e prefektit.”. Elementet e kësaj page janë sipas pikës 2 të VKM-në nr. 187, datë 8.03.2017. Aktualisht, kjo pagë referuese bazë, llogaritet mbi vlerën 118,100 lekë, e cila rezulton si shtesë e pozicionit të kategorisë II-a në lidhjen nr. 1 të kësaj VKM-je.

Pensioni suplementar:

Pensioni suplementar, i cili përfitohet nga kjo kategori punonjësish në bazë të nenit 21 “Pensioni suplementar dhe përfitimet e tjera”, të ligjit nr. 96/2016, pika 2, ligjit nr. 8097, datë 21.3.1996 “Për pensionet shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit”, i ndryshuar dhe VKM-së nr. 548, datë 27.7.2016, “Për miratimin e kriterëve, rregullave dhe të procedurave për përfitimin e pensione shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit”.

2. Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Referimi në Raport	Rëndësia	Rekomandimi
1	a) Përcaktimi i “pagës referuese bazë” në nenin 12, pika 5, germa a) të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si i njëjtë me pagën e kategorisë së parë, klasa e tretë, është i gabuar. Sipas VKM-së nr. 187 datë 08.03.2017, paga referuese bazë e magjistratit, duhet llogaritur si shuma e elementit të parë të pagës së DDPK, me elementin e katërt, i cili është shtesa për pozicion në vlerën 118,100 lekë. b) Nga auditimi i listëpagesave, u konstatua se “Shtesa për pagën në grup” është aplikuar në masën 106% të pagës referuese bazë mbi të cilën janë kryer llogaritjet, ndërsa “Shtesa për pozicion drejtues”, është aplikuar vetëm për Kryetarin dhe zv/Kryetarin, përkatësisht 10 dhe 5%, por nuk është llogaritur për pozicionet e tjera, d.m.th. për kryetarin e seksionit, magjistratin e shtypit, këshilltarin e etikës ose të magjistratit udhëheqës (në qoftë se këto pozicione aplikohen), sipas përcaktimeve në ligjin nr. 96/2016.	Fq. 10-11	E lartë	1. Për të gjithë magjistratët, pavarësisht nga pozicioni i tyre i punës (kategoritë G1, G2 dhe G3), paga referuese bazë të përllogaritet mbi bazën e plotë të pagës së Drejtorit të Drejtorisë së Përgjithshme në Kryeministri, e cila përbëhet nga paga e grupit, plus shtesën e pagës (132,100 = 14,000 + 118,100) dhe jo siç përllogaritet aktualisht, vetëm mbi shtesën për pozicion (118,100). Pagesa duhet të bëhet duke filluar nga momenti i hyrjes në fuqi të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (ose emërimit, për personat e punësuar pas kësaj date) dhe të përllogaritet për të gjithë periudhën, bashkë me të gjitha shtesat dhe pakësimet, sipas rastit. 2. Për pozicionet e tjera, si kryetar i seksionit, magjistrat i shtypit, këshilltar i etikës ose magjistrat udhëheqës (në qoftë se këto pozicione aplikohen), të përllogaritet shtesa prej 5% mbi pagën bazë të grupit (G1, G2 apo G3, sipas rastit).
2	Anëtarët e KLGJ-së të cilët nuk janë zgjedhur nga rradhët e sistemit gjyqësor, diskriminohen duke mos përllogaritur vjetërsinë e punës që nga momenti i fillimit në detyrë, pavarësisht se ligji u ka dhënë statusin e magjistratit, ndërkohë që nuk i ka njëvlerësuar në mënyrë respektive me Gjykatën e Lartë.	Fq. 12-13	E lartë	Menaxhimi administrativ dhe Sektori i Financës i Këshillit të Lartë Gjyqësor, të marrin masa duke analizuar rastet, duke proceduar sipas kërkesave ligjore për zgjidhjen e problemit, si dhe duke e institucionalizuar atë, pa bërë analogji dhe interpretim mekanik të ligjit dhe pa diferencuar anëtarët e KLGJ-së midis tyre, në llogaritjen e vjetësisë në punë.
3	Nga auditimi i listëpagesave, u konstatua se anëtarëve të KLGJ-së, si dhe punonjësve të tjerë të administratës së KLGJ-së, të cilët	Fq. 13-14	E lartë	1. Menaxhimi administrativ dhe Sektori i Financës i Këshillit të Lartë Gjyqësor, të marrin masa që nga të gjithë punonjësit e KLGJ-

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Referimi në Raport	Rëndësia	Rekomandimi
	janë subjekt i ligjit nr. 8097, datë 21.3.1996, nuk u ndalet nga paga vlera e cila duhet të derdhet për pension suplementar. Problemi i mosqënies së KLGJ-së në listat e përfituesve të pensionit suplementar, kur të vijë momenti i daljes në pension të punonjësve, është trajtuar dhe zgjidhur në pikën 10 të VKM-së nr. 548, datë 27.7.2016, ndërsa problemi i mospagesës së kontributeve për pension suplementar aktualisht nuk zgjidhet dhe punonjësit të cilët e përfitojnë me ligj këtë pension nuk mund ta marrin kur të vijë koha e pensionit, pasi nuk kanë paguar kontributet përkatëse të përcaktuara me ligj.			së, të cilët përfitojnë pension suplementar, të mbahen nga paga kontributet për pensionet suplementare dhe të derdhen çdo muaj në fondin e sigurimit shtetëror suplementar, jo më vonë se fundi i muajit pasardhës. 2. Menaxhimi administrativ dhe Sektori i Financës i Këshillit të Lartë Gjyqësor, të marrin masa për zgjidhjen e ngërçit institucional, me qëllim që Drejtoria Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Tiranë, të pranojë kontributet për sigurimin suplementar nga KLGJ, si një e drejtë dhe detyrim i parashikuar nga ligji, duke ushtruar edhe të drejtën e ankimimit Gjyqësor, nëse do jetë e nevojshme.

3. Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit

Struktura e pagave për anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor, është bazuar në referencë të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe VKM-së nr. 187, datë 08.03.2017 “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në Kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e Presidentit, Kuvendit, Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Gjykatën e Lartë, Prokurorinë e Përgjithshme, disa institucione të pa varura, institucionet në vartësi të Kryeministrit, institucione në vartësi të ministrive të linjës dhe administratën e prefektit.”, i ndryshuar. Nga auditimi u konstatua se:

- Ka mospërputhje midis termave të referencës së ligjit dhe VKM-së, gjë e cila ka sjellë për pasojë pasaktësi në strukturën e pagave të aplikuar nga KLGJ, të cilat janë bazuar në interpretimin dhe zbatimin e termave të referencës, mbi gjykime subjektive.
- KLSH, vlerëson se, lidhur me ndalesën dhe pagesën e sigurimit për pension suplementar, nuk ka ngërç ligjor, ndaj është e nevojshme që nga KLGJ, të ndërmerren menjëherë iniciativat e nevojshme, me qëllim që Drejtoria Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Tiranë, të pranojë kontributet për sigurimin suplementar nga KLGJ, si një e drejtë dhe detyrim i parashikuar nga ligji, duke ushtruar edhe të drejtën e ankimimit Gjyqësor nëse do jetë e nevojshme.

II. HYRJE

1. Objekti dhe qëllimi i auditimit

Dhënia e vlerësimeve të pavarura mbi përputhshmërinë e llogaritjeve të pagave, me fokus të veçantë ndër të tjera vjetërsinë në punë si dhe kuadrin ligjor dhe rregullator mbi të cilin mbështetet përlllogaritja e tyre.

2. Identifikimi i çështjes

Raporti Përfundimtar i Auditimit, synon të identifikojë çështjet të cilat janë shkak për deviacionet nga kuadri rregullator i ndërtimit të strukturës së pagave, përlllogaritjes së tyre, përlllogaritjen e vjetërsisë në punë, kontributet për pensionet suplementare, si dhe të japë rekomandimet e nevojshme për përmirësimin e gjendjes.

3. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese

Strukturat drejtuese të KLGJ-së, janë përgjegjëse për përgatitjen e pagave të anëtarëve të KLGJ-së, përfshi stafin administrativ dhe atë mbështetës, në përputhje me kuadrin ligjor e aktet nënligjore.

4. Përgjegjësitë e Audituesve

Përgjegjësia e grupit të auditimit është të shprehë konkluzionin dhe rekomandimet përkatëse mbi çështjet që janë nën auditim. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit sipas INTOSAI-t. Këto standarde, kërkojnë që audituesit të respektojnë kërkesat etike, si dhe të planifikojnë dhe kryejnë auditimin me qëllim arritjen e nivelit të sigurisë së kërkuar.

Përgjegjësia jonë (e audituesve të KLSH-së), është që nëpërmjet auditimit të realizuar të krijohen bindjet, si dhe të jepen rekomandimet përkatëse mbi aspektet që duhet të vlerësojë:

- a. Nëse kuadri ligjor rregullator për përlllogaritjen e pagave, vjetërsisë në punë dhe pensioneve suplementare është i plotë;
- b. Nëse janë zbatuar kërkesat e përcaktuara në ligjet dhe aktet nënligjore përkatëse, si Ligjet organike të institucionit, Ligji për pensionet suplementare, si dhe aktet nënligjore përkatëse, etj.;
- c. Fusha specifike, të cilat janë objekt i fokusit për zbatimin e ligjit, etj.

Në përputhje me ISSAI 1320 dhe ISSAI 1450, objektivi i audituesit është që të aplikojë konceptin e materialitetit në mënyrë korrekte gjatë planifikimit dhe kryerjes së auditimit. Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për të marrë evidenca auditimi të mjaftueshme rreth praktikave administrative e financiare, në lidhje me pagesat e kryera apo që duhet të ishin kryer për llogaritjen e pagave dhe përfshirjen e të gjithë elementëve përbërës të tyre. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, duke përfshirë këtu edhe vlerësimin e rreziqeve nga gabimi material, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

5. Kriteret e vlerësimit

Legjislacioni bazë dhe dytësor, dispozitat e tjera, si dhe kriteret përkatëse që janë përdorur dhe ju jemi referuar për kryerjen e vlerësimeve gjatë auditimit:

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Ligji nr. 154/2014 “*Mbi Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*”;
- Ligji nr. 96/2016, “*Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë*”;
- Ligji nr. 115/2016, “*Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë*”;

- Ligji nr. 8097, datë 21.3.1996, “Për pensionet shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 10405, datë 24.3.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”;
- VKM-ja nr. 187, datë 8.03.2017 “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në Kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e Presidentit, Kuvendit, Komisionit Qendror të zgjedhjeve, gjykatën e lartë, prokurorinë e përgjithshme, disa institucione të pa varura, institucionet në vartësi të kryeministrit, institucione në vartësi të ministrive të linjës dhe administratën e prefektit.”;
- VKM-ja nr. 548, datë 27.7.2016, “Për miratimin e kriterëve, rregullave dhe të procedurave për përfitimin e pensioneve shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit”.

6. Standardet e auditimit

- ISSAI 100 “Parimet themelore të auditimit të sektorit publik” i cili përcakton parimet themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi;
- ISSAI 2000-2899 “Standardet e Auditimit Financiar”;
- ISSAI 2300 “Planifikimi i auditimit të pasqyrave financiare”;
- INTOSAI GOV 9100 “Udhëzues mbi Standardet e Kontrollit të Brendshëm për Sektorin Publik” si dhe INTOSAI GOV 9110 “Udhëzues mbi raportimin e efektivitetit të kontroleve të brendshëm”;
- ISSAI 400 “Parimet themelore të auditimit të përputhshmërisë”, i cili përcakton parimet themelore të ISSAI-t 100 dhe i zhvillon më tej ato duke i përshtatur me kontekstin specifik të auditimit të përputhshmërisë;
- ISSAI 4000 “Prezantim i përgjithshëm i udhëzimeve për auditimin e përputhshmërisë”; si dhe ISSAI 4200 “Udhëzime për auditimin e përputhshmërisë”;
- Praktika të mira të fushës, si Manuali i Auditimit Financiar dhe ai i Përputhshmërisë të Gjykatës Evropiane të Audituesve; Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t,
- Rregullorja e procedurave të auditimit të KLSH-së.

7. Metodat e auditimit

- Kontrolli aritmetik.

Duke konsideruar faktin se në thelb, kontabiliteti konsiston në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike (që është edhe qëllimi i kontabilitetit), bëhen një seri veprimesh të cilat kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin, kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim.

- Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese.

Edhe pse kontabilizimet mund të mos përmbajnë gabime aritmetike, ato mund të jenë të gabuara, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin. Për kontrollin e pjesëve justifikuese, u përdor auditimi me zgjedhje të njëpasnjëshme deri në aritjen e një opinionimi mbi gjetjet e konstatuara.

- Intervista

- Raporte dhe Informacione

- Korrespondenca

8. Dokumentimi i auditimit

Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit, i konsideruar si i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit, të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore. Rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra gjatë auditimit, si dhe çështje të tjera të rëndësishme që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre sipas gjykimit dhe skepticizmit profesional që audituesit ushtruan në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe ka shërbyer si një burim informacioni për përgatitjen e tyre. Në përfundim të auditimit në terren dhe Akt-Verifikimit të mbajtur mbi bazën e të dhënave të grumbulluara, u përgatit ky Raportit Përfundimtar i Auditimit.

Evidencat mbështetëse si dhe dokumentacioni i përgatitur nga Grupi i Auditimit, janë pjesë e Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Në kryerjen dhe dokumentimin e auditimit, u morrën në konsideratë parimet e mëposhtme të auditimit financiar:

- Etika dhe pavarësia;
- Kontrolli i cilësisë;
- Menaxhimi i grupit të auditimit dhe aftësive të tyre;
- Parimet lidhur me konceptet bazë të auditimit.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim

Në përgatitjen e materialit dokumentar për planifikimin e auditimit, grupi i auditimit i është referuar dokumentacionit të kërkuar subjektit, si dhe bazës ligjore e akteve nënligjore lidhur me fushën e auditimit.

Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ), është i organizuar dhe funksionon në bazë ligjit nr. 115/2016 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”.

Ky subjekt nuk është audituar ndonjëherë më parë nga KLSH-ja, gjë e cila është vlerësuar si element i riskut në veprimtarinë audituese.

Auditimi është inicuar bazuar në shkresën nr. 5108, datë 13.10.2020 të KLGJ-së, protokolluar në KLSH me nr. 1029 prot., datë 14.10.2020, në lidhje me mënyrën e përlllogaritjes së pagave, vjetërsisë në punë dhe pensioneve suplementare.

2. Përshkrimi i i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit

2.1 Verifikimi i përlllogaritjes së pagave me fokus të veçantë ndër të tjera vjetërsinë në punë si dhe kuadrin ligjor dhe rregullator mbi të cilën mbështetet përlllogaritja e tyre.

Titulli i gjetjes 1: Probleme në interpretimin dhe zbatimin e bazës ligjore të strukturës së pagave dhe përlllogaritje e pagave bazuar në intepretime të pa argumentuara në mënyrën e duhur ligjore.

Situata: Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nga Drejtoria e Financës, listëpagesat, korrespondencat ndërmjet institucioneve, krahasimi i terminologjisë dhe përkufizimeve të përdorura në ligjet bazë nr. 96/2016 dhe 115/2016, me VKM-në nr. 187, datë 08.03.2017, u konstatua se:

1. Përcaktimi i “pagës referuese bazë” në nenin 12, pika 5, germa a) të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si i njëjtë me pagën e kategorisë së parë, klasa e tretë, është i gabuar, pasi në VKM-në së cilës i referohet, **nuk ekziston emërtimi kategoria e parë, klasa e tretë**. Në lidhjen nr. 1 të VKM-së, klasa I dhe klasa II kanë nga dy kategori, përkatësisht kategoritë I-a, I-b dhe II-a e II-b. Nga ana tjetër, pozicionit të Drejtorit të Drejtorisë së Përgjithshme në Kryeministri (DDPK), së cilës i referohet ligji nr. 96/2016 për llogaritjen e pagës së magjistratit, në lidhjen nr. 1 të VKM-së nr. 187 datë 08.03.2017, i korrespondon klasa II, kategoria II-a e pagës. Termi “pagë për funksion”, sipas përcaktimit në ligj, nuk gjendet në VKM, por, llogaritjet të cilat janë bërë duke iu referuar “shtesës për pozicion” në lidhjen nr. 1 të saj, sipas vlerësimit tonë nuk janë të sakta, pasi paga e funksionit të DDPK është paga totale mujore e këtij punonjësi, e cila duhet të ishte njësuar dhe përdorur si referenca që përmendet në ligjin nr. 96/2016, por nuk mund të njësohet me “shtesën për pozicion”. Sipas VKM-së nr. 187 datë 08.03.2017, paga e pozicionit të DDPK, përbëhet nga 4 elementë, të cilët janë: 1. Paga e grupit, 2. Shtesa për vjetërsi, 3. Shtesa për kualifikim dhe 4. Shtesa për pozicion (kolonat 2+3+4+5 të lidhjes nr. 1 të VKM-së 187, datë 08.03.2017). Tre elementët e parë, përbëjnë **pagën bazë** dhe elementi i fundit, është **shtesa për pozicion**, siç edhe emërtohet. Nga auditimi, rezultoi se për llogaritjen e **pagës për**

funksion, është marrë në konsideratë **vetëm shtesa për pozicion**, në vlerën 118,100 lekë. Sa më sipër, paga referuese bazë e magjistratit, duhet llogaritur si shuma e elementit të parë të pagës së DDPK, (paga e grupit sipas lidhjes 2 të VKM-së 187, datë 08.03.2017 në vlerën 14,000 lekë) me elementin e katërt, i cili është shtesa për pozicion në vlerën 118,100 lekë (pasi vjetërsia në punë dhe pagesa për kualifikimin/titujt shkencorë në rastin e magjistratëve llogariten mbi pagën referuese bazë të grupit).

2. Nga auditimi i listëpagesave, u konstatua se “*Shtesa për pagën grup*” është aplikuar në masën 106% të pagës referuese bazë mbi të cilën janë kryer llogaritjet, ndërsa “*Shtesa për pozicion drejtues*”, është aplikuar vetëm për Kryetarin dhe zv/Kryetarin, përkatësisht 10 dhe 5%, por nuk parashikohet të përllogaritet për pozicionet e tjera, d.m.th. për kryetarin e seksionit, magjistratin e shtypit, këshilltarin e etikës ose të magjistratit udhëheqës (në qoftë se këto pozicione aplikohen), sipas përcaktimeve në ligjin nr. 96/2016.

Kriteri:

- Ligji nr. 96/2016 “*Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë*”, Nenet 12 dhe 14;
- Ligji nr. 115/2016 “*Për Organizimin e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë*”, Nenet 3 dhe 4;
- VKM-ja nr. 187, datë 8.03.2017 “*Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në Kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e Presidentit, Kuvendit, Komisionit Qendror të zgjedhjeve, gjykatën e lartë, prokurorinë e përgjithshme, disa institucione të pa varura, institucionet në vartësi të kryeministrit, institucione në vartësi të ministrive të linjës dhe administratën e prefektit.*”, Pika 2, Lidhja 1, Lidhja 2.

Ndikimi/Efekti: Përfitime të reduktuara pa të drejtë kundrejt magjistratëve të punësuar në Këshillin e Lartë Gjyqësor.

Shkaku: Probleme në interpretimin dhe zbatimin e ligjeve specifike dhe mospërputhje e mos-homogjenizim i terminologjisë së përdorur në ligjet organike, me aktet e tjera ligjore ekzistuese. Mosnjohje dhe keqinterpretim i akteve të tjera ligjore e nënligjore në fuqi.

Rëndësia: E lartë

- Rekomandime:**
1. Për të gjithë magjistratët, pavarësisht nga pozicioni i tyre i punës (kategoritë G1, G2 dhe G3), paga referuese bazë të përllogaritet mbi **bazën e plotë** të pagës së Drejtorit të Drejtorisë së Përgjithshme në Kryeministri, e cila përbëhet nga paga e grupit, plus shtesën e pagës (132,100 = 14,000 + 118,100) dhe jo siç përllogaritet aktualisht, vetëm mbi shtesën për pozicion (118,100). Pagesa duhet të bëhet duke filluar nga momenti i hyrjes në fuqi të ligjit nr. 96/2016 “*Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë*” (ose emërimit, për personat e punësuar pas kësaj date) dhe të përllogaritet për të gjithë periudhën, bashkë me të gjitha shtesat dhe pakësimet, sipas rastit.
 2. Për pozicionet e tjera, si kryetar i seksionit, magjistrat i shtypit, këshilltar i etikës ose magjistrat udhëheqës (në qoftë se këto pozicione do të aplikohen në të ardhmen), të përllogaritet shtesa prej 5% mbi pagën bazë të grupit (G1, G2 apo G3, sipas rastit).

Titulli i gjetjes 2: Probleme në interpretimin dhe zbatimin e bazës ligjore lidhur me llogaritjen e shtesës mbi pagë për vjetërsinë në punë, për anëtarët jo gjyqtarë të KLGJ-së, të cilët nuk kanë qenë pjesë e sistemit gjyqësor.

Situata: Për shkak të interpretimit dhe zbatimit të gabuar të ligjit, anëtarët e KLGJ-së të cilët nuk janë zgjedhur nga rradhët e sistemit gjyqësor, diskriminohen duke mos përlllogaritur vjetërsinë e punës që nga momenti i fillimit të ushtrimit të funksionit, pavarësisht se ligji u ka dhënë statusin e magjistratit, ndërkohë që nuk i ka njëvlerësuar në mënyrë respektive me Gjykatën e Lartë. Në nenin 4, pika 2, të ligjit 115/2016 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, përcaktohet se “Anëtari i Këshillit gëzon pagën dhe përfitimet e gjyqtarit të Gjykatës së Lartë...”. Ligjvënësi jo rastësisht e ka përdorur termin juridik në numrin njëjës “...e gjyqtarit...”, pasi ka pasur synimin që për anëtarët e KLGJ-së, të mos ketë asnjë rëndësi përbërja e Trupës Gjyqësore të Gjykatës së Lartë, në magjistratë gjyqtarë (të atyre që vijnë nga sistemi gjyqësor) apo në magjistratë jo gjyqtarë (të atyre që vijnë nga jashtë sistemit gjyqësor). Pra në kuptimin e përcaktimit të mësipërm, anëtari apo anëtarët e KLGJ-së gëzojnë **statusin financiar** të “Gjyqtarit” të gjykatës së lartë, **në këndvështrimin preferencial** dhe pa u bërë dallimi midis anëtarëve gjyqtarë dhe jo gjyqtarë të kësaj gjykate. Ky përcaktim ligjor, lidhet me zbatimin e **nenit 12**, “Caktimi i pagës së magjistratit”, të ligjit 96/2016, në të cilin përcaktohen të gjithë elementët përbërës së pagës, ndër të tjera edhe elementi i vjetërsisë në punë (pika 3).

Ndërkohë që në **pikën 4** të po këtij neni, në formën e një përjashtimi nga rregulli, përcaktohet se për gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, të emëruar nga rradhët e juristëve që nuk vijnë nga karriera gjyqësore, për efekt të përcaktimit të vjetërsisë së ushtrimit në detyrë, shtesa për vjetërsi llogaritet në mënyrë të barasvlershme me atë të 15 vjetëve karrierë gjyqësore...”. Nga auditimi, u konstatua se aktualisht përlllogaritja e vjetërsisë në punë, bëhet duke iu referuar përmbajtjes së këtij paragrafi, duke sjellë për pasojë një interpretim të gabuar, si dhe një “aplikim mekanik” të këtij paragrafi edhe ndaj anëtarëve jo gjyqtarë të KLGJ-së. Për këtë arsye, grupi i auditimit mendon se duhet ndryshuar **analogjia e gabuar** që zbatohet, si dhe **interpretimi i pasaktë** që i është bërë përmbajtjes së **nenit 4, pika 2 e ligjit 115/2016 dhe paragrafit 4 të nenit 12, të ligjit 96/2016**. Ligjvënësi, në **pikën 4 të nenit 12** të ligjit 96/2016, përjashtimisht dhe **në mënyrë taksative**, ka bërë një përcaktim ligjor referues, në lidhje me “vjetërsinë në punë”, të anëtarëve jo gjyqtarë të Gjykatës së Lartë. Ky rregullim ligjor, në asnjë rast nuk mund të përfshijë në sferën e tij të zbatimit, “kategori të tjera subjektsh” përveç atyre që ligjvënësi i përmend në mënyrë taksative, çka do të thotë që përfshin “...vetëm anëtarët jo gjyqtarë të Gjykatës së Lartë...”. Pra, në thelb nuk mund të bëhet një **“analogji”** e kësaj natyre, nëpërmjet aplikimit apo një “zbatim mekanik”, i përmbajtjes së këtij paragrafi, duke barazuar “pozitën juridike” të anëtarëve jo gjyqtarë të KLGJ-së me atë të anëtarëve jo gjyqtarë të Gjykatës së Lartë. Nisur nga prezumimi i hershëm ligjor se: “...Ligji atë ç’ka nuk e ndalon, e lejon...”, është logjike që, për asnjë arsye nuk mundet që ky rregullim ligjor, i cili i përfshin në sferën e tij të zbatimit anëtarët jo gjyqtarë të

Gjykatës së Lartë, të mund të zbatohet edhe për anëtarët jo gjyqtarë të KLGJ-së. Këshilli i Lartë Gjyqësor është një Organ Kushtetues, Kolegjial dhe i Pavarur dhe kjo pozitë kushtetuese gjen shprehje të qartë dhe të drejtpërdrejtë edhe në përmbajtjen e nenit 4, pika 2 të ligjit 115/2016, për sa iu njeh këtyre të fundit; ...pagën dhe privilegjet e gjyqtarit të gjykatës së lartë.... Gjithashtu, kur flitet për “Anëtari i Këshillit gëzon pagën dhe përfitimet...”, referimi nuk mund të përfshijë dhe elemente të tjerë specifike të pagës, të cilat ligji i ka përjashtuar për një grup konkret të përcaktuar të anëtarëve të Gjykatës së Lartë. Në qoftë se anëtarët jogjyqtarë të KLGJ-së do të trajtoheshin njësoj si anëtarët jogjyqtarë të Gjykatës së Lartë, minimalisht në ligj do të ishte vendosur fjala “përkatësisht” ose një përcaktim tjetër i ngjashëm.

- Kriteri:**
- Ligji nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Neni 12.
 - Ligji nr. 115/2016 “Për Organizimin e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, Neni 4.
- Ndikimi/Efekti:** Diferencim në mënyrën e llogaritjes të pagës së magjistratëve anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor megjithëse gëzojnë të njëjtën pozitë juridike dhe janë me të njëjtin status ligjor.
- Shkaku:** Probleme në interpretimin dhe zbatimin e ligjeve specifike dhe vendosja e analogjisë së padrejtë, midis anëtarëve jogjyqtarë të Gjykatës së Lartë, me anëtarët jogjyqtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor.
- Rëndësia:** E lartë
- Rekomandime:** Menaxhimi administrativ dhe Sektori i Financës i Këshillit të Lartë Gjyqësor, të marrin masa duke analizuar rastet, duke proceduar sipas kërkesave ligjore për zgjidhjen e problemit, si dhe duke e institucionalizuar atë, pa bërë analogji dhe interpretim mekanik të ligjit dhe pa diferencuar anëtarët e KLGJ-së midis tyre, në llogaritjen e shtesës për vjetërsi.

Titulli i gjetjes 3: Mosllogaritja, mosndalja dhe mosderdhja e kontributeve për pension suplementar.

Situata: Nga auditimi i listëpagesave, u konstatua se anëtarëve të KLGJ-së, si dhe punonjësve të tjerë të administratës së KLGJ-së, të cilët janë subjekt i ligjit nr. 8097, datë 21.3.1996, nuk u ndalet nga paga vlera e cila duhet të derdhet për pension suplementar. Në lidhje me arsyet e mosndalimit aktual të shumës që duhet të paguajnë punonjësit për efekt të pensionit suplementar, nga Drejtoria e Financës pretendohet që institucioni dhe personeli i KLGJ-së nuk është i përfshirë në listat përkatëse sipas VKM-së nr. 548, datë 27.7.2016, si më sipër. Për të zgjidhur këtë ngërç, nga KLGJ janë hartuar disa shkresa drejtuar Kryeministrit, Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Ministrisë së Drejtësisë, etj., ku kërkohet përfshirja e KLGJ-së dhe pozicioneve/ funksioneve të punës në listën e personave të cilët përfitojnë pension suplementar. Ministria e Financave dhe e Drejtësisë, janë përgjigjur se kjo çështje do të trajtohet në ndryshimet përkatëse të akteve ligjore e nënligjore për pensionet suplementare. Nga auditimi, u konstatua se me shkresën e Drejtorisë Rajonale të Institutit të Sigurimeve Shoqërore, Dega Tiranë nr. 581/1 prot., datë 10.06.2019, protokolluar në KLGJ me nr. 3117 prot., datë 11.06.2019, nga kjo e fundit

i bëhet e ditur KLGJ-së se emri i këtij institucioni nuk figuron në listën bashkëlidhur VKM-së nr. 548, datë 27.7.2016.

Nga grupi i auditimit gjykohet se përfshirja e KLGJ-së në listën e institucioneve përfituese, nuk ka të bëjë me institucionet, punonjësit e të cilëve kontribuojnë për të përfituar pensionin suplementar kur të vijë koha e pensionit. Kjo listë trajton përfituesit e pensioneve suplementare, pasi kontribuesit dhe mënyra e intervali kohor i pagesës së këtyre kontributeve, janë përcaktuar qartësisht në ligjin nr. 8097, datë 21.3.1996, në nenet 1, 5 dhe 6. VKM-ja nuk mund të ndalojë, kufizojë apo tjetërsojë atë që është përcaktuar shprehimisht në ligj. Megjithatë, problemi i mosqënies së KLGJ-së në listat e përfituesve të pensionit suplementar, kur të vijë momenti i daljes në pension të punonjësve, është trajtuar dhe zgjidhur në pikën 10 të VKM-së nr. 548, datë 27.7.2016¹, ndërsa problemi i mospagesës së kontributeve për pension suplementar aktualisht nuk zgjidhet dhe punonjësit të cilët e përfitojnë me ligj këtë pension nuk mund ta marrin kur të vijë koha e pensionit, pasi nuk kanë paguar kontributet përkatëse të përcaktuara me ligj.

- Kriteri:**
- Ligji nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Neni 21;
 - Ligji nr. 8097, datë 21.3.1996 “Për pensionet shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit”, i ndryshuar, Nenet 1, 4, 5 dhe 6;
 - VKM-ja nr. 548, datë 27.7.2016, “Për miratimin e kriterëve, rregullave dhe të procedurave për përfitimin e pensioneve shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit”, Pikat 5 dhe 10.

Ndikimi/Efekti: Privim i punonjësve të KLGJ-së nga e drejta për të përfituar pension suplementar. Mungesë të ardhurash për buxhetin e shtetit. Dhënie në formë page e shumës e cila duhet të ndalet nga paga për efekt të pensionit suplementar dhe tatimi i kësaj shume si e ardhur.

Shkaku: Mosnjohje dhe keqinterpretim i akteve ligjore e nënligjore të tjera në fuqi.

Rëndësia: E lartë

- Rekomandime:**
1. Menaxhimi administrativ dhe Sektori i Financës i Këshillit të Lartë Gjyqësor, të marrin masa që nga të gjithë punonjësit e KLGJ-së, të cilët përfitojnë pension suplementar, të mbahen nga paga kontributet për pensionet suplementare dhe të derdhen çdo muaj në fondin e sigurimit shtetëror suplementar, jo më vonë se fundi i muajit pasardhës.
 2. Menaxhimi administrativ dhe Sektori i Financës i Këshillit të Lartë Gjyqësor, të marrin masa për zgjidhjen e ngërçit institucional, me qëllim që Drejtoria Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Tiranë, të pranojë kontributet për sigurimin suplementar nga KLGJ, si një e drejtë dhe detyrim i parashikuar nga ligji, duke ushtruar edhe të drejtën e ankimit Gjyqësor, nëse do jetë e nevojshme.

¹ Në rastet kur në momentin e lindjes të së drejtës për përfitime suplementare, në aktet ligjore apo nënligjore përkatëse **nuk ekziston institucioni dhe mungon funksioni/pozicioni/detyra** dhe paga për atë funksion/pozicion/detyrë, paga referuese përcaktohet nga Departamenti i Administratës Publike, duke bërë njësimin e funksionit/pozicionit/detyrës, për të cilin nuk ka pagë, me funksione/pozicione të ngjashme.

Për sa është trajtuar në Projektraportin e Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresën nr. 5251/5 prot., datë 14.01.2021, “*Sqarime në lidhje me Projektraportin e Auditimit, për gatitur nga përfaqësuesit e autorizuar të KLSH-së*”, e cila është protokolluar në KLSH me nr. 1029/5 prot., datë 15.01.2020, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Shënim:

Në këtë sqarim të kundërshtive të paraqitura nga subjekti i audituar “Këshilli i Lartë Gjyqësor”, me qëllim praktikitetin dhe mospërsëritjen e komenteve, fakteve dhe rrethanave të përmendura në Projektraportin e auditimit, si dhe të bazës ligjore të përdorur, është paraqitur vetëm thelbi i kundërshtive, në formë të përmbledhur. Kundërshtitë janë pjesë e dosjes së auditimit në formë fizike, me nënshkrimet origjinale të personave të atakuar.

Grupi i auditimit, pasi i lexoi me shumë kujdes këto kundërshti, pa anshmëri, me gjykim dhe skepticizëm profesional, thekson se do të marrë në konsideratë vetëm shpjegimet të cilat janë shoqëruar me dokumente dhe argumente ligjore shtesë, si dhe me prova të reja shkresore të cilat kanë mbështetje ligjore, ndërsa ato shpjegime të cilat nuk gjejnë argumenta, por janë vetëm justifikuese, nuk do të merren në konsideratë dhe do të trajohen përsëri në këtë Raport Përfundimtar të Auditimit.

Nga subjekti i audituar, Këshilli i Lartë Gjyqësor, përgjithësisht është shkruar i gjithë Projektraporti i auditimit, por nuk janë dhënë argumente apo referenca të reja ligjore, të panjohura për grupin e auditimit. Konkretisht:

1. Subjekti i audituar shprehet se: *Auditimi është inicuar bazuar në ankimimin e anëtarëve të KLGJ-së, në lidhje me mënyrën e përlllogaritjes së pagave, vjetërsisë në punë dhe pensioneve suplementare..., etj.*

Qëndrimi i grupit të Auditimit:

Edhe pse sa më sipër nuk ndikon në cilësinë e punës së kryer, observacioni merret parasysht. .

2. Subjekti i audituar shprehet se: *...strukturat përgjegjëse për buxhetin dhe financën në KLGJ, kanë bërë vetëm zbatimin e akteve ligjore e nënligjore në fuqi, dhe kurrësi interpretim të bazës ligjore, apo të pa argumentuara në mënyrën e duhur ligjore..., etj.*

Qëndrimi i grupit të Auditimit:

Ky pretendim nuk qëndron, pasi është një arsyetim i pambështetur në evidenca dhe/ose në akte ligjore e nënligjore të panjohura për grupin e auditimit.

3. Subjekti i audituar, pasi citon pothuajse të plotë pjesën përkatëse të Projektraportit të auditimit, shprehet se: *...Nuk është e vërtetë se nuk ekziston emërtimi kategoria e parë, klasa e tretë..., etj.*

Qëndrimi i grupit të Auditimit:

Ky pretendim nuk qëndron, pasi është i pa bazuar. Konkretisht, kategoria e parë dhe e dytë kanë vetëm nga dy klasa. Subjekti i audituar, ngre pretendimin se: *...Këshilltari i Etikës është i jashtëm dhe me kohë të pjesshme, si dhe që shtesa e pagës i paguhet në institucionin e tij bazë..., etj.*

Qëndrimi i grupit të Auditimit:

Ky pretendim qëndron pjesërisht, pasi vërtet Këshilltari aktual i etikës mund të jetë i jashtëm dhe me kohë të pjesshme, por ky lloj pozicioni, sipas nenit 79 “Organizimi i administratës” të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, përcakton se KLGJ-ja duhet të ketë zyrë të posaçme për Këshilltarin e Etikës dhe jo një punonjës të jashtëm me kohë të pjesshme.

4. Subjekti i audituar, ngre pretendimin se: *...nuk ka sjellë asnjë dëm ndaj magjistratëve në KLGJ-së..., etj.*

Qëndrimi i grupit të Auditimit:

Ky pretendim nuk qëndron, pasi pagimi në një nivel më të ulët nga sa është përcaktuar me ligj, përbën dëm për magjistratët, pavarësisht se në cilin pjesë të sistemit gjyqësor

apo të prokurorisë punojnë. Kjo çështje është sqaruar gjerësisht në Raportin Përfundimtar të Auditimit, faqe 10-14.

5. Subjekti i audituar, ngre pretendimin se: *...nga ana e përfaqësuesve të KLSH-së, nuk na është vënë në dukje mos njohja dhe keqinperpretim i akteve ligjore dhe nënligjore, apo të na njihte me ndonjë akt të ri ligjor apo nënligjor..., etj.*

Qëndrimi i grupit të Auditimit:

KLSH ka mbajtur aktet e konstatimit, ka përgatitur projekt raportin dhe raportin përfundimtar të auditimit në përputhje me Rregulloren e Procedurave të Auditimit të KLSH-se. Në këto kushte, ky pretendim nuk qëndron, pasi detyra e audituesve të KLSH-së është auditimi në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi si dhe me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit dhe jo trajnimi i punonjësve. (neni 15 “Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së”, ligji nr. Ligji Nr. 154-2014, “Për Organizimin dhe Funksionimin e KLSH-së”).

6. Subjekti i audituar, ngre pretendimin se: *...zbatimi i këtij rekomandimi, duke aplikuar si pagë referuese bazë vlerën prej 132,100 lekë, do të sjellë një efekt financiar shumë të madh në buxhetin e shtetit, e aq më tepër kur rekomandimi parashikon zbatimin e tij që nga hyrja në fuqi e këtij ligji. Gjithashtu duhet kuptuar se ky efekt financiar për buxhetin e shtetit përfshin të gjithë magjistratët (gjyqtarë e prokurorë) si dhe gjithë pozicionet në institucionet e tjera shtetërore me paga të barasvlefshëm me pagat e magjistratëve të nivele të ndryshme. Ky efekt buxhetor i rekomanduar duhet të perceptohet drejt për vlerat që do të rezultojnë, referuar numrit të përfituesve ku do të shtrijë efektin dhe kohës për të cilën rekomandohet të zbatohet.*

Qëndrimi i grupit të Auditimit:

Kjo “sjellje në vëmendje” qëndron nga ana logjike, por, theksojmë se pagesa e punonjësve sipas ligjit është detyrim ligjor dhe duhet përmbushur që në momentin e lindjes së të drejtës për pagë., Punonjësit, kanë detyrim zbatimin e kushtetutës dhe ligjeve.

7. Subjekti i audituar, ngre pretendimin se: *...Pozicionet e përmendura të cilat përfitojnë shtesën 5%, nuk ekzistojnë në strukturën organizative në KLGJ-së dhe si rrjedhim nuk kanë bazë për t’u zbatuar.*

Qëndrimi i grupit të Auditimit:

Idem pika 4 më sipër.

8. Subjekti i audituar, ngre pretendimin se: *...strukturat përgjegjëse për buxhetin dhe financën, kanë bërë vetëm zbatimin e akteve ligjore e nënligjore në fuqi, në përlllogaritjen dhe pagesën e shtesës për vjetërsi në ushtrimin e funksionit të magjistratit (gjyqtarit) dhe kurrësi interpretim të bazës ligjore..., etj.*

Qëndrimi i grupit të Auditimit:

Grupi I auditimit, pasi shqyrtoi me kujdes observacionit shprehet se, ky pretendim nuk qëndron, pasi e gjejmë të pa argumentuar dhembështetur në evidenca dhe në akte ligjore e nënligjore të panjohura për grupin e auditimit.

9. Subjekti i audituar, veç të tjerave, pasi ka shkruar të plotë këtë pjesë të projektraportit dhe bazën ligjore përkatëse, ngre pretendimin se: *...Për sa më sipër sqarojmë se; Për sa përshkruani se,,,Për shkak të..., Në vlerësimin tonë, edhe këtu në nenin 4, në pikën 3, pika 4 dhe pikën 5, ligjvënisi ka bërë një përcaktim të qartë të anëtarëve gjyqtar dhe anëtarëve jogjyqtar. Sipas pikës 2, anëtari i Këshillit gëzon pagën dhe përfitimet e gjyqtarit të Gëkatës së Lartë, por sipas pikës 1, anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor ka statusin e magjistratit, por vetëm sipas rregullave të parashikuara nga ligji “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe nga ky ligj, pra edhe përfitimet do të marrë sipas përcaktimeve të ligjit 96/2016. Vlerësojmë se ju keni bërë interpretim të ligjit, tagër të cilin e ka vetëm*

Gjykata Kushtetuese..., etj.

Qëndrimi i grupit të Auditimit:

Grupi I auditimit, pasi shqyrtoi me kujdes observacionit shprehet se, ky pretendim nuk qëndron, pasi në ligj nuk përcaktohet që anëtari i KLGJ-së, magjistrat me origjinë jo gjyqtare duhet të paguhet më pak se kolegu magjistrat me origjinë gjyqtare. Theksojmë se, grupi i audituesve të KLSH-së nuk ka bërë interpretim të ligjeve duke marrë atributet e Gjykatës Kushtetuese, por ka konstatuar interpretimin e gabuar të ligjeve nga administrata e KLGJ-së, në bzaë të së cilit kërkohet ndryshimi i situatës dhe heqja e diskriminimit

10. Subjekti i audituar, ngre pretendimin se: *...nga ana e strukturës përgjegjëse për buxhetin dhe financat, nuk është bërë asnjë diferencim në mënyrën e llogaritjes së vjetërsisë në funksion..., etj.*

Qëndrimi i grupit të Auditimit:

Idem pika 10 më sipër.

11. Subjekti i audituar, ngre pretendimin se: *...struktura përgjegjëse për buxhetin dhe financat, nuk ka vendosur analogji të padrejtë, midis anëtarëve jogjytarë të GJL dhe jogjytarë të KLGJ-së..., etj.*

Qëndrimi i grupit të Auditimit:

Idem pikat 10 dhe 11 më sipër.

12. Subjekti i audituar, ngre pretendimin se: *...nga ana e strukturës përgjegjëse për buxhetin dhe financat, në përlllogaritjen e vjetërsisë në ushtrimin e funksionit... ka proceduar sipas akteve ligjore në fuqi dhe nuk ka bërë asnjë diferencim midis anëtarëve të KLGJ-së..., etj.*

Qëndrimi i grupit të Auditimit:

Idem pikat 10,11 dhe 12 më sipër.

13. Subjekti i audituar, ngre pretendimin se: *...është përlllogaritur, mbajtur dhe derdhur vlera e sigurimit shoqëror suplementar, si për anëtarët e këshillit ashtu edhe për administratën e saj..., etj.*

Qëndrimi i grupit të Auditimit:

Pavarësisht se fillimisht është përlllogaritur, mbajtur dhe derdhur vlera për sigurimin shoqëror suplementar, në momentin që kjo derdhje nuk është pranuar nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore e Shëndetësore, dega Tiranë, nga administrata e financës së KLGJ-së nuk është kërkuar zbatimi i pikës 10 të VKM-së nr. 548, datë 27.7.2016 “Për miratimin e kriterëve, rregullave dhe të procedurave për përfitimin e pensioneve shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit”, ku përcaktohet shprehimisht procedura që ndiqet në rastet kur institucionet nuk janë në listën në fjalë. Sa më sipër, në kushtet e refuzimit të padrejtë të derdhjes së këtyre kontributeve, gjykojmë se KLGJ duhet t’i ishte drejtuar menjëherë gjykatës.

14. Subjekti i audituar, ngre pretendimin se: *...janë përlllogaritur, mbajtur dhe derdhur vlerat e sigurimit shoqëror suplementar, si për anëtarët e këshillit ashtu edhe për administratën e saj..., etj.*

Qëndrimi i grupit të Auditimit:

Idem pika 14 më sipër.

15. Subjekti i audituar, ngre pretendimin se: *...është e drejtë se është privuar e drejta e punonjësve të KLGJ-së (pjesë e së cilës jemi edhe ne), nga e drejta për pension suplementar, në momentin e daljes në pension, por kjo ka ardhur si rezultat i mos përfshirjes në këtë skemë të institucionit të KLGJ-së..., etj.*

Qëndrimi i grupit të Auditimit:

16. Subjekti i audituar, ngre pretendimin se: *...Do të ishte në të mirën e të gjithë punonjësve*

të KLGJ-së, zbatimi i këtij rekomandimi..., etj.

Qëndrimi i grupit të Auditimit:

Sa më sipër, audituesit e KLSH-së kanë konstatuar një shkelje për të cilën kanë hartuar rekomandimin përkatës. Është detyra e administratës së KLGJ-së të gjejë modalitetet e zbatimit të rekomandimit.

17. Subjekti i audituar, ngre pretendimin se: *...Këshilli i Ministrave i ka dërguar për shqyrtim dhe miratim Kuvendit të Shqipërisë, Projektligjin "Për disa ndryshime dhe shtesa në në ligjin nr. 8097, datë 21.3.1996 "Për pensionet shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve shtetit", i ndryshuar, përgatitur nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, në bashkëpunim me Institutin e Sigurimeve Shoqërore..., etj.*

Qëndrimi i grupit të Auditimit:

Idem pika 18 më sipër

18. Nga subjekti i audituar, janë bërë komente në lidhje me qëndrimin e grupit të auditimit për observacionin e bërë pas Aktit të Verifikimit, të cilat janë paraqitur në Projektraportin e auditimit, janë sqaruar nga grupi i auditimit dhe nuk janë pranuar, pasi nuk është paraqitur asnjë dokument apo bazë ligjore e panjohur nga grupi i auditimit.

Qëndrimi i grupit të Auditimit:

Duke qenë se nga subjekti i audituar janë bërë përsëritje të komenteve të mëparshme, pa dhënë asnjë element të ri, të panjohur për grupin e auditimit, duke qenë se këto pretendime janë trajtuar më parë në Projektraportin e auditimit dhe nuk qëndrojnë, konkludojmë se janë justifikime dhe të pambështetura në evidenca dhe në akte ligjore e nënligjore të panjohura për grupin e auditimit.

19. Idem pika 3, 5, etj., si më sipër.

20. Idem pika 3, 5, etj., si më sipër.

21. Idem pika 4, etj., si më sipër.

22. Idem pika 3, 5, etj., si më sipër.

23. Idem pika 4 dhe 8 më sipër.

24. Idem pika 3, 5, etj., si më sipër.

25. Idem pika 4, etj., si më sipër.

26. Idem pikat 14, 15, 16, etj., si më sipër.

27. Idem pikat 14, 15, 16, etj., si më sipër.

28. Idem pikat 14, 15, 16, etj. si më sipër.

Shkresa me kundërshtitë përkatëse është nënshkruar nga personat e atakuar, R. B., L. L. dhe Xh. H.

Grupi i auditimit, pasi i lexoi me shumë kujdes këto kundërshti, pa anshmëri, me gjykim dhe skepticizëm profesional, konstaton se këto shpjegime janë të njëjta me ato të cilat i janë bërë të ditura grupit të auditimit gjatë zhvillimit të auditimit.

Shënim: Krahës sa është cilësuar më sipër, sjellim në kujtesë të personelit përkatës të atakuar në këtë auditim, se në shkresën nr. 5108, datë 13.10.2020, të dërguar KLSH-së nga KLGJ, ku kërkohet auditimi, në paragrafin e fundit, rreshti i parë, cilësohet si problem interpretimi i ndryshëm i ligjit...

IV. KONKLUZION I PËRGJITHSHËM DHE OPINIONI I AUDITIMIT

Struktura e pagave për anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor, është bazuar në referencë të ligjit nr. 96/2016 *“Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”* dhe VKM-së nr. 187, datë 08.03.2017 *“Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në Kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e Presidentit, Kuvendit, Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Gjykatën e Lartë, Prokurorinë e Përgjithshme, disa institucione të pa varura, institucionet në vartësi të Kryeministrit, institucione në vartësi të ministrive të linjës dhe administratën e prefektit.”*, i ndryshuar. Nga auditimi u konstatua se:

- Ka mospërputhje midis termave të referencës së ligjit dhe VKM-së, gjë e cila ka sjellë për pasojë pasaktësi në strukturën e pagave të aplikuara nga KLGJ, të cilat janë bazuar në interpretimin dhe zbatimin e termave të referencës, mbi gjykime subjektive.
